



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:082171
Datë: 17.10.2024
Numri i dokumentit: 06313027

C.nr.479/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Blerina KURTAJ, në çështjen juridike - kontestimore sipas padisë së paditësit P.P nga fsh. Qerim, Komuna Gjakovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra për Shërbime juridike “Pasuria”, me seli në Gjakovë, kundër të paditurit Komuna e Gjakovës, me objekt kontesti: padi për rivlerësimin e pronës së shpronësuar, me 17 Tetor2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET E TËRHEQUR, padia e evidentuar me numër të lëndës C.nr.497/27, e paraqitur nga paditësit P.P nga Komuna Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, me objekt kontesti: padi për rivlerësimin e pronës së shpronësuar, e datës 05.02.2024.
- II. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit, në këtë gjykatë, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar, ka paraqitur padi kundër të paditurës me objekt kontesti padi për rivlerësimin e pronës së shpronësuar, në vlerë të përgjithshme prej 5,000.00 Euro.

Me datën 04.10.2024 përfaqësuesi i autorizuar e paditësit ka dorëzuar në gjykatë një parashtresë për tërheqjen e padisë.

Gjykata konstaton se parashtresën për tërheqjen e padisë nga i autorizuari i paditëseve dhe njoftimin për tërheqje i ka dorëzuar të paditurës dhe brenda afatit të përcaktuar ligjor nuk janë deklaruar lidhur me parashtresën për tërheqje të padisë.

Sipas dispozitave ligjore nga neni 261 par. 1,2,3,4,5 të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se: “pala paditëse ka të drejtë ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri të paraqet përgjigjen në padi, padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë. Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë. Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri”, u vendos si në piken **I** dhe **II** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së, si në piken **III** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet ligjore konform dispozitave ligjore nga neni 261 e lidhur me nenin 387 par.1 pika ‘c’ dhe nenit 142.1 të LPK, duke vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lartë, gjykata, në bazë të Nenit 261, paragrafi 3, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e konstatoi të tërhequr padinë e paditësit, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në lidhje me këtë, Neni 261, paragrafi 3, i Ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ashtu siç është plotësuar dhe ndryshuar, tash e tutje referuar si “Ligji për Procedurën Kontestimore”, shprehimisht parasheh se “po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar më parë” .

Nga sa u tha më lartë, gjykata, në bazë të Nenit 261, paragrafi 3, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e konstatoi të tërhequr padinë e paditësit, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.479/24; me 17 Tetor 2024

Gj y q t a r j a,

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa, bazuar me nenin 261, paragrafin 4, të Ligjit për Procedurën Kontestimore.